



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1460/2 Prot.

Tiranë, më 01 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 133, Datë 01 / 10 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 120, datë 25.09.2019, të bërë nga B.S kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Është banor në lagjen “Beqir Dardha” Elbasan dhe familja e tij përbëhet nga 5 anëtarë. Në vitin 2017 ka nënshkruar një akt-marrëveshje me OSHEE për shlyerjen e debisë së akumuluar në vite. Sipas asaj marrëveshje ai duhej të shlyente 1200 lekë në muaj këstin e akt-marrëveshjes si dhe faturën mujore. Të ardhurat e familjes së tij janë 3960 në muaj që vijnë nga përfitimi i ndihmës ekonomike. Deri në muajin Shkurt 2018 ka respektuar kushtet e marrëveshjes dhe pas këtij muaji për shkak të pamundësisë ekonomike nuk ka mundur të paguajë detyrimet. Që nga ajo kohë OSHEE ka ndërprerë furnizimin me energji elektrike. Në muajin Shtator 2019 është paraqitur pranë zyrës së OSHEE Elbasan për të kërkuar lidhjen e një akt-marrëveshje të re me qëllim shlyerjen e debisë dhe rilidhjen e energjisë elektrike. Nga punonjësit e OSHEE është informuar se nënshkrimi i akt-marrëveshjes së re kushtëzohet me pagimin e menjëhershëm të detyrimeve të prapambetura të viteve 2018 dhe 2019. Ankuesi shprehet se për shkak paaftësisë paguese, familja e tij rrezikon të mbesë përgjithmonë pa energji elektrike”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe furnizimin me energji elektrike, duke marrë në konsideratë aftësinë paguese të konsumatorëve familjarë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3/1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Pas analizimit të ankesës nr. 120, datë 25.09.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, megjithatë me e-mail-in datë 26.09.2019 iu kërkua ankuesit që të plotësonte ankesën me dokumentet si më poshtë: Kopje të dokumentit që përfiton ndihmë ekonomike, kopje të certifikatës familjare, kopje të kontratës të furnizimit me energji elektrike dhe kopje të kërkesës së bërë për rilidhjen e enërgjisë elektrike dhe përgjigjeve të marra nga OSHEE.

Në vijim, ankuesi B.S dërgoi pranë KMD-së, e-mail-in datë 30.09.2019 në të cilin kishte bashkëngjitur kërkesën e datës 27.09.2019, nëpërmjet së cilës kërkonte të tërhiqte ankesën e tij

kundër OSHEE, për arsye se OSHEE kishte marrë vendim për ti ulur pagesën fillestare për rilidhjen e furnizimit me energji elektrike.

Referuar kërkesës me shkrim të bërë nga subjekti ankues, në të cilën heq dorë nga pretendimet e tij, Komisioneri bazuar në nenin 94/1 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në të cilën parashikohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të shqyrtimit të ankesës nr. 120, datë 25.09.2019 të B.S kundër OSHEE sh.a, pasi ankuesi ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA